

Secili mësues duhet të mbajë shënime lidhur me pjesët kryesore të mësimit teoriko - profesional të tij. Në vijim me anë të h yrjes, p jesës kryesore dhe përfundimit do të demonstron mënyra më e thjeshtë dhe më e qartë. Preferohet planifikimi i kohës së nevojshme, hapave të veprimit dhe metodave. Të gjitha që ju duhet ti dini gjatë orës mësimore, duhet të jenë të përfshira në përgatitjen me shkrim të mësimit.

Përmbajtja e përgatitjes me shkrim të orës mësimore



- Përshkrimi i hyrjes në orën mësimore
- hapat e planifikuar të orës mësimore me ndarje të përafërt kohore
- rezultatet e pritura të orës mësimore
- aplikimi i metodave
- pyetjet e rëndësishme duhet të jenë të parapërgatitura
- udhëzime mbi aplikimin e mediave, fletëve të punës dhe punës tabelare

Nëse keni përvojë të mangët në përgatitjen me shkrim të orës mësimore, duhet të bëni planifikimin sa më të saktë të hapave të veprimit!

Sqarimi i emërtimeve

Qëllimet mësimore kognitive	→	Ndërmjetësimi i njohurive
Qëllimet mësimore afektive	→	Ndërmjetësimi i pikëpamjeve
Qëllimet mësimore psikomotorike	→	Ndërmjetësimi i shkathtësive manuale

Shembull i përgatitjes së orës mësimore

(mësimi teoriko profesional):

Tema:	Pajisjet mbrojtëse personale dhe përdorimi i tyre (45`)
Qëllimi i mësimit:	Shiqo Curriculum - in
Kognitiv:	Nxënësi duhet të fitojë një pasqyrë lidhur me rregulloren e sigurisë në punë si dhe lidhur me pajisjet mbrojtëse personale dhe të njohet me karakteristikat e tyre
Afektiv:	Nxënësit duhet të njohin rëndësinë e zbatimit preciz dhe të kujdesshëm të masave mbrojtëse dhe të kenë vullnet ti aplikojnë ato
Njoftim:	Nxënësit janë në fazën fillestare të shkollimit dhe nuk kanë kurrëfarë njohurish paraprake

Përgatitja me shkrim e orës mësimore

Koha	Hapat e veprimit	Metodat/ Format e punës/ Mediat
	Përshëndetja	
5'	1. Hapi i parë Demonstrimi / Prezantimi i ndonjë fatkeqësie në punëtori apo i ndonjë sjellje të gabuar -Principi i qartësimi të qëllimit -Principi i përshtatshmërisë në moshë	Foto/ Folie Përshkrimi i shembujve nga përvoja personale
25'-30'	2. Pjesa kryesore Shembujt dhe përvojat e prezentuara duhet të shënohen në dërrasëz afishimi (Pinnwand) Kush është përgjegjës për siguri? -Principi i sistematikës -Principi i vrojtimit (të pamurit) Cilat pajisje mbrojtëse janë të njohura? -Mbrojtja e kokës , helmata -Mbrojtja e syve dhe fytyrës , syzet mbrojtëse -Mbrojtja e rrugëve të frymëmarjes, maska mbrojtëse -Mbrojtja e dëgjimit, mbuluesit e veshëve Të radhiten sipas prioritetit! -Principi i aktivizimit Mësidhënësi përpilon pikat kyçe të sigurisë në punë: -Siguria shkon para shpejtësisë -Parandalimi i dëmeve shkon para - rregullimit -Përgjegjësia personale shkon para përgjegjësisë së huaj -Përgjegjësia e të gjithëve për njërin si dhe e njërit për të gjithë	Dërrasëz afishimi - Nxënësit bëjnë përmbledhjen e shembujve Metoda pyetëse-zhvillimore Shënimi i përgjigjeve në dërrasëz afishimi Metoda pyetëse-zhvillimore Nxënësit emërtojnë shembuj mbi pajisjet mbrojtëse dhe i përmbledhin ato (p.sh. në një folie) Ligjërime të shkurtër (Puna me projektorin overhead apo me dërrasëz afishimi) Metoda e prezentimit , demonstrimit
10'-15'	3. Përfundimi Pyetja: Çka mund të përmirësohet në punëtori lidhur me çështjen e sigurisë? -Principi i afërsisë praktike Nxënësit evidentojnë dituritë e diskutimit -Principi i sigurimit të suksesit	Shënimi i mendimeve (sygjerimeve) të nxënësve në dërrasëz afishimi Fletat e punës



Mua më pëlqen përqindja e lartë e punimeve të nxënësve në këtë orë mësimore. Me çka arrihet një përqindje e tillë prej rreth 60% ?

- Përfshirja e përvojave dhe mendimeve të nxënësve
- Diskutimi (Metoda pyetëse-zhvillimore)
- Puna me nxënës në dërrasëz afishimi dhe tabelë
- Puna me fleta pune

(Sqarimet lidhur me metodat e mësimit në kapitullin 5)